

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Sot me date 12.12.2023 , ortaku i vetem i shoqerise si me poshte;

Z. Kelvin Çobanaj lindur me 22.10.1998 ne Durres, i identifikuar me Nr paersonal J81022061S bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosi hapjen e statutit te shoqerise ne baze te ligjit te lart permendur.

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.

Objekti I shoqerise

1.1. Shoqeria ka kete objekt veprimtarie:

Të kryejë sipërmarrje dhe shërbime shëndetësore në fushat :dermatologji, transplantin e flokëve dhe mjekësi kozmetike. etj; Importim te produkteve mjekesore apo farmaceutike te nevojshem për ushtrimin e shërbimeve të mësipërme.

Neni 2.

Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaku i vetem vendosi qe shoqerine ta emertoje .

EUROPEAN HAIR CLINIC SHPK



- 2.2. Selia juridike e Shoqerine ndodhet ne
Njesi N6, me numer pasurie 107/49+1-N6, Zk 3292, Vol.60, Fa.153, Selite, Tirane.
- 2.3. Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3.

Regjimi Juridik

- 3.1 Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.
- 3.2. Me vendim te tij Ortaku i vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premise me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.
- 3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin
- 3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT,KOHEZGJATJA

Neni 4.

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

- 4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .
- 4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijoj pasuri materiale dhe intelektuale.



- 4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.
- 4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.
- 4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj
- 4.6. Ortaku perballon humbjet e shoqerise vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij ne kapitalin themeltar.

Neni 5.

Kohezgjatja

- 5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

- 6.1. Kapitali themeltar eshte 100.000 Leke dhe eshte i ndare ne 1kuote e cila i perket ortakut te vetem.
- 6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte : 1
- 6.3. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem
- 6.4. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.



Neni 7

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

- 7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise. 7.2.Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaket, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakut te vetem.

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

- 8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- 8.2. Emertimi i shoqerise tregtare,kapitali themeltar,NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.
- 8.3. Organet kryesore te shoqerise jane : Asambleja e Pergjithshme e perbere nga ortaku i vetem, administratori dhe eventualisht Eksperti kontabel i autorizuar.

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise

Asambleja e pergjithshme perbehet nga ortaku i vetem i shoqerise qe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrime te asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem.

Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administratori,Eksperti kontabel i autorizuar ose ortaku i vetem i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.



Njoftimi me shkresë apo me mesazhi elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se shtatë ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Ortaku mund të përfaqësohet në asambleë nëpërmjet një përfaqësuesi, duke qenë i autorizuar me prokurë të posaçme, dhe të marrin vendime vetëm për ato çështje që diskutohen në mbledhjen për të cilën ata kanë marrë të drejtën e përfaqësimit.

Mbledhjet e asambleës pasqyrohen në procesverbalin që mbahet me këtë rast, ndërsa vendimet nënshkruhen nga ortaku i vetëm.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Ortaku i vetëm i shoqërisë ka të drejtë të marrë vendime për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar.
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronja "c" dhe "ç" të kësaj pike.
- dh) Mbiqyrtjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asambleës
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Kreu V
ADMINISTRIMI
Neni 10

- 10.1. Shoqeria do te administrohet nga I (nje) administrator i vetem, i cili mund te zgjidhet edhe jashte ortakeve te shoqerise.
- 10.2. Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Ortaku i vetem. 10.3. Administrimi i shoqerise do behet nga Kelvin Cobanaj.
- 10.4. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 vite me te drejte ripertesitje ne perfundim te mandatit.
- 10.5. Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.
- 10.6. Administratorit i takon firma e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.
- 10.7. Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve , per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres
- 10.8. Kompetencat kryesore te administmtorit ne shoqeri jane:
- kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaku i vetem :
 - perfaqeson shoqerine tregtare.
 - kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
 - pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim
 - krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
 - kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
 - raporton perpara ortakut te vetem ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
 - kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.



- administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortakut i vetem.
- kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise
- te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjithe veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.
- ti propozoje ortakut te vetem per miratim strukturen e aparatit te Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise .
- ti propozoje ortakut te vetem per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

Neni 11

Marreveshjet e ndaluara

- 11.1. Administratorit ose ortakut qe nuk jane persona juridike nuk u lejohej te kontraktojne ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.

Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme. Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj perfaqesuesve ligjore te ortakeve qe jane persona juridike.

- 11.2. Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve te personave te cituar ne paragrafin e pare te ketij neni, si dhe ndaj çdo personi ndermjetes.

Kreu VI

VIT1 FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 12

- 12.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

- 12.2. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar , raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaku i vetem.
- 12.3 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13

Kontrolli i Shoqerise

- 13.1. Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortakut i vetem.
- 13.2. Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar , si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise , kontrollon pershtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit dhe ne raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizoje eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.
- 13.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakut te vetem.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 14

- 14.1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaku.
- 14.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj .Per kryerjen e ketij Procesi, ortakut i vetem emerohet nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise , mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.
- 14.3. Ne fund le procesit te likujdimit, ortakut i vetem vendoset mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujdimit, dhe mbyllet procesi i likujdimit.



- 14.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakun e vetem te shoqerise.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrveshjeve

- 15.1. Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor.

Kreu VIII


DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 16

- 16.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut , do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe legjislacionit koherent
- 16.2. Ky statut hartohet ne 4 (kater) kopje, secila me te njejten vlere ligjore.Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Kelvin Çobanaj

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Kelvin Çobanaj', with a stylized flourish underneath.